

VENDIM
Nr.439, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 3. c) tabelat nr.2 “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të policisë së ndërtimit në rrethe” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.12.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela Nr. 2**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË
NDËRTIMIT NË QENDËR**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Drejt看		II-a
2.	Zevendesdrejt看		II-b
3.	Kryetar Dege	XXII	36700
4.	Shef Sektori	XXII	36700
5.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXII	36700
6.	Specialiste	XXI	34500
7.	Shofer	IX	19900
8.	Punonjes Grupi Gadishmerie	XIX	29300
9.	Arkivist. Dkatilografist. Protokollist	VI	17500
10.	Magaznier	VI	17500
11.	Sekretare, daktilografiste.	VI	17500
12.	Punonjes Sherbimi	III	16400
13.	Pastruese	I	16000

Tabela Nr. 2

**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË
NDËRTIMIT NË RRETHE**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Kryetar Dege K1	XXII	36700
2.	Kryetar Dege K2	XXI	34500
3.	Shef Sektori	XXI	34500
4.	Specialist i larte	XX	31300
5.	Specialsit i mesem	VIII	18800
6.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXI	34500
7.	Specialist Grupi Gadishmerie	XIX	29300
8.	Arkivist - Protokollist	VI	17500
9.	Shofer	IX	19900